



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	216 / 16
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	27. 10. 2016
VUSHTRRI - VUÇITRN	



## Republika e Kosovës


## Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 “d”, në lidhje me nenin 51.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 41.1 “ç” në lidhje me nenin 54.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 tetor 2016** mori këtë:

### VENDIM

### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR. 197/14, DT.29.09.2014

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.197/14, dt.29.09.2014 për emërimin e anëtarëve të KPF-së me sa vijon:  
Emërohet anëtare e KPF-së Syzana Sylja në vend të Fatime Hazirit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë



Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 217/16

Nr. i fq. / Br. ot - 1 -

Data: / Datum 27. 10. 2016

VUSHTRRI - VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 7 dhe 10 paragrafi 1 pika 1.5 e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 11 dhe 20 pika 11 të Rregullores QRK NR.23/2013 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr.03/L-184 për Energjinë, si dhe nenit 41.2 pika “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më **27 tetor 2016**, mori këtë:

**VENDIM**  
**PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË**  
**PALUAJTSHME KOMUNALE**

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 20 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë në sipërfaqe prej 20 m<sup>2</sup> të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme 14732 m<sup>2</sup> e cila është pjesë e ngastrës kadastrale nr.P-70202016-00001-1, Zona Kadastrale Vushtrri prone e komunës.
2. Nga ngastra kadastrale e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi i jepet KEDS-it në shfrytëzim afatgjatë për 20 vite pa kompensim, sipërfaqja prej 20m<sup>2</sup> për vendosjen e trafostacionit.
3. Komuna me implementimin e Planeve Urbanistike siç janë: Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme, KEDS-i apo ndonjë subjekt juridik, i cili menaxhon në këtë trafostacion obligohet të largojë trafostacionin me të gjitha investimet e tyre.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Obligohet Kryetari i komunës dhe përfaqësuesi i autoritet qendror në cilësinë e dhënësit në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në njërin anë dhe ndërmarrjes KEDS-it në anë tjetër (si shfrytëzues i pronës), që të nënshkruajnë kontratën.
6. Pjesë e këtij vendimi janë: certifikata për të drejtën e pronës, kopja e planit.
7. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesues i Kuvendit**





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

18/0313

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-00001-1

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number:

18-1721s/16

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

04.10.2016-10:42

Komuna / Opština / Municipality:

Vushtri/Vučitri/Vushtri

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

VUSHTRRI/VUSHTRRI/VUSHTRRI

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Vushtri/Vučitri/Vushtri

Drejtori/Direktor/Director

Referenti/Referent/Referent

A. TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. unit No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta inovine Property Type	Zona U/R U/R U/R	Sipërfaqja Površina Area m <sup>2</sup>	Përshkrimi Opis Description	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-70202016-00001-1	PARCEL/PARCEL/ PARCEL		U	14732		09.07.2013	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Kodi postar Poštanski fih Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
QYTET/PARK/QYTET/PARK/QYTE T/PARK	-	//	09.07.2013	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIÇENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriçenja parcelë Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriçenje parcelë Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kualiteta Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Toke Tjetër/Ostalo Zemljište/Other land	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		14732

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. no.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi postali Poštanski fah Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronarë)/Individualno Vlasništvo (1 VL.)single owner	P SH .KOMUNA E VUSHTRRIË	KCID0201037	VDSHTTRR/VUSHTRR/ VUSHTRRI	-	// 2	1/1		



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


Zyra kadastrale komunale /Opstinska kancelarija: Vushtri  
Zona kadastrale / katastarska zona: Vushtri  
Lloji i njësish kadastrale /Vrsta kadastarske jedinice: \_\_\_\_\_

Nr. i njësish kadastrale /Br.kadastarske jedinice: K-4865-1  
Numri i lëndës / Broj predmeta: 18-

18/6308 KOPJE PLANI / KOPIJA PLANA / COPY OF PLAN



P-1:500



Dat. 04.10.2016

Drejtori:



Republika e Kosovës  
Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Urbanizëm  
dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM)



Zona Kadastrale: **Vushtrri**

Parc, kad. 1-1


Sip.e përgjithshme: **S=14732 m<sup>2</sup>**

Sipërfaqja e objektit: **S=18 m<sup>2</sup>**


Etazhiteti i lejuar; **P+0**

Destinimi i objektit: **Trafostacion**


Më. 04. 10. 2016 vit.



Skica e lokacionit që kërkohet për vendosje të trafostacionit



Gjeometri

  
Isa Latifi - gjeometër

Zyrtari për leje ndërtimore

  
Ramiz Maliqi - ida



REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E MUSHKUTISË - PËTAS VUSHTRISË

01 Nr./Br 218/16

Nr. i fq./Br. st - 1 -

Data: / / 27. 10. 2016

MUSHKUTISË



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në mbështetje të nenin 73 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 56 paragrafi 1,2 dhe 3, dhe nenit 57.1 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 8.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 tetor 2016** mori këtë:

### VENDIM

#### PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR ANËTARËSIM NË KOMITETIN KONSULTATIV PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

1. Me këtë vendim shpallet konkursi për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta.
2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, duke përfshirë qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, të cilët janë njohës të fushëveprimtarisë së komunës.
3. Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenin 4.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
**Kryesues i Kuvendit**